



## GJITHÇKA RRETH KUJDESIT PËR FËMIJËT E TE PORSAADHURVE (CARE FOR NEWCOMER CHILDREN – CNC)

*Mirësevini! Programi ynë CNC është hartuar veçanërisht për të mbështetur fëmijët që sapo kanë mbërritur në Kanada si dhe familjet e tyre kur ata aksesojnë shërbimet e financuara nga IRCC. Jemi këtu për t'ju ndihmuar.*

*E kuptojmë që kjo është periudhë e ndryshimeve të thella për ju dhe familjen tuaj. Qëllimi ynë është që fëmija juaj të ndjehet i mirëpritur, i sigurt dhe i qetë ndërkohë që mbështesim zhvillimin e tyre dhe ndërtimin e vetbesimit të tyre ndërsa familja juaj stabilizohet në Kanada.*

**NË KOHËN QË NJË FËMIJË ËSHTË NË PROGRAMIN CNC, PRINDËT DUHET TË JENË FIZIKISHT ATY GJATË GJITHË KOHËS.**

### Nuk ka asgjë më të rëndësishme se siguria e fëmijës suaj!

Mund të jeni të sigurtë që personeli ynë është i kualifikuar dhe me përvojë.

- I gjithë personeli ka kaluar nën kontrollin e rekordeve kriminale dhe janë trajnuar për marrjen e ndihmës së parë.
- Ne ndjekim Kërkesat e CNC dhe ato monitorohen për të siguruar që ne i plotësojmë standartet e shëndetit dhe të sigurisë.
- Për t'u siguruar se të gjithë fëmijët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe me respekt, ne kemi një politikë të manaxhimit të sjelljes. Personeli duhet medoemos të përforcojë sjelljen në mënyra pozitive. Nuk lejohet dënimi fizik apo të folurit ashpër me fëmijët, as edhe neglizhimi i tyre dhe mungesa e mbikqyrjes.
- Personeli ka detyrë profesionale dhe detyrim ligjor të raportojë tek autoritetet përkatëse çdo situatë në të cilën një fëmijë mund të jetë dëmtuar apo neglizhuar.

Jeni të lirë të na kërkonit një kopje të politikës sonë të manaxhimit të sjelljes ose kopje të politikës për dyshimin që një fëmijë është abuzuar/neglizhuar nëse jeni të interesuar të dini më shumë.

### Çfarë mund të prisni nga CNC?

Mënyra se si kujdesemi për fëmijët në grup në Kanada mund të jetë e ndryshme nga ajo në vendin tuaj. Nëse keni pyetje për disiplinën, ushqimin, gjuhën, edukimin dhe rutinën, ju lutem pyesni. Studimet tregojnë që fëmijët mësojnë përmes lojës, ndaj personeli planifikon veprimtari mësimore edukuese me baze loje për t'ju përshtatur kësaj interesave, moshës, aftësive dhe kulturës së fëmijëve. Fëmija juaj do të praktikojë shoqërimin me fëmijët e tjerë dhe do të zhvillojë aftësi të cilat do t'i përgatisin ata për në shkollë.

### Si mund ta ndihmojmë fëmijën tuaj të pershtatet me CNC?

Është normale që fëmija juaj të ketë frikë para se të nisë CNC. Personeli do të punojë me ju për ta bërë këtë tranzicion sa më të lehtë, por, në fillim, fëmija mund të qajë, nuk do të dojë të ndahet nga ju, ose do të demostrojë sjellje të tjera. Për më shumë ide se si mund t'i ndihmoni fëmijët tuaj t'u lehtësohet frika, kërkonit një kopje të *Mirësevini në CNC*. Udhëzues për Prindët rreth *Shkëputjes së Suksesshme*.

### Komunikimi ndërmjet prindërve dhe personelit është i rëndësishëm!

Ju inkurajojmë të njiheni me personelin tonë të CNC dhe të ndani me ta informacion rreth fëmijës suaj. Kur punojmë të gjithë bashkë, mund ta mbështesim më mirë fëmijën tuaj dhe t'i mbajmë ata të sigurtë.

## GJITHÇKA RRETH KUJDESIT PËR FËMIJËT E TE PORSAADHURVE (CARE FOR NEWCOMER CHILDREN – CNC)

### Sigurohuni t'i tregoni personelit rreth:

- alergjive dhe ndonjë kufizim ushqimor;
- sëmundjeve apo mjekimeve që merr fëmija juaj (ju lutem vini re: mjekimet jepen vetëm në situata kur rrezikohet jeta dhe kurrë nuk duhet lënë në çantën e fëmijës);
- si dhe nevojat e veçanta apo sfidat. Ato mund të na vijnë ndihmë!

### Gjithashtu mund të jetë e dobishme t'i tregoni personelit:

- orën se kur fle fëmija juaj apo kur e ushqeni;
- interesat dhe ushqimet e preferuara të fëmijës suaj;
- fjalët që mund të ndihmojnë personelin për të komunikuar me fëmijën tuaj;
- informacion rreth familjes dhe vëllezërve dhe motrave (ose sillni një foto të familjes);
- si dhe mënyrat specifike si kujdeseni për fëmijën tuaj dhe ato që mund të dëshironi nga CNC.

### Gjera të tjera që duhet të keni parasysh:

- Për sigurinë e fëmijës suaj, vetëm prindi që është regjistruar për shërbimet tona mund të sjellë dhe të marrë fëmijët e tyre.
- Duhet medoemos të shenoni sa herë që e sillni dhe e merrni fëmijën tuaj.
- Vishini fëmijët tuaj në mënyrën e duhur sipas motit dhe veprimtarive që do kenë në program. Nëse keni pyetje se çfarë duhet të veshë fëmija juaj, pyesni personelin.
- Është e rëndësishme ta sillni fëmijën regullisht që të ruajnë rutinën e tyre dhe të përgatiten për në shkollë. Nëse fëmija juaj do të mungojë, njoftoni personelin.
- Nëse fëmija juaj është sëmure, mbajeni në shtëpi për të parandaluar përhapjen e sëmundjes. Fëmijët që kanë qenë me temperaturë dhe diarre duhet të mos kenë asnjë simptomë 24 orë para se të kthehen në CNC.

## GJITHÇKA RRETH PROGRAMIT CNC

**Emrat e kujdestarëve:** \_\_\_\_\_  
Caregiver's Name / Nom du dispensateur de soins

**Orari i CNC:** \_\_\_\_\_  
CNC Hours / Heures de garde d'enfant

	Po Yes / Oui	Jo Non / Non
<b>Kërkohet dokumenti i imunizimit</b> Immunization required / L'enfant doit avoir été vacciné	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<b>Ne sigurojmë snacks</b> We provide snacks / Nous fournissons des collations	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<b>Sillni ushqim për drekën</b> Bring food for your child's lunch/snack / Apportez le déjeuner/la collation de votre enfant	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<b>Për drekën e fëmijës suaj do të kujdeseni ju</b> You care for your child at lunch / Vous prenez soin de votre enfant au déjeuner	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<b>Ne kemi një kohë gjumi në drekë</b> We have a naptime / Notre programme prévoit une sieste	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

	Po Yes / Oui	Jo Non / Non
<b>Sillni nje lodër të butë</b> Bring a comfort toy / Apportez un jouet réconfortant	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<b>Sillni rroba ekstra</b> Bring extra clothes / Apportez des vêtements supplémentaires	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<b>Sillni këpucë/papuçe për</b> Bring indoor shoes / Apportez des chaussures d'intérieur	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<b>Sillni një batanije (nëse është e nevojshme)</b> Bring a blanket (if needed) / Apportez une couverture (si nécessaire)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
<b>Sillni pampers (nëse është e nevojshme)</b> Bring diapers (if needed) / Apportez des couches (si nécessaire)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>



**MBËSHËTETJA E KUJDESIT DHE STABILIZIMIT  
TË FËMIJËVE TË EMIGRANTËVE TË RINJ**

Për më shumë informacion për prindet, vizitoni faqen:  
[www.cmascanada.ca](http://www.cmascanada.ca)



Care for  
Newcomer  
Children